

## KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH

Sot me date **06/12/2020**, (dy mije e njezet), midis paleve u nenshkrua kjo kontrate shitblerje kuotash te Shoqerise Proftrans:

**PALA SHITESE:** **Z. Ilir Vardhami**, shtetas shqiptar, i biri i Jani, lindur më 07/03/1969 në Gjirokaster, banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit (kartë identiteti) me nr. Personal G90307185K, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ortak i Shoqërisë **“PROFTRANS” Sh.p.k.** zoterues me 2.4 % te kapitalit te shoqerise, Rruga Llazi Miho, zona kadastrale 3712, me numer pasurie 300/56, Vaqarr, Tirane e regjistruar si person juridik ne QKB me date 25/01/2018 me NIPT L81325027S, ne vijim i quajtur **Shitës;**

### **PALA BLERESE:**

**Shoqeria “ADR TRANS” shoqeri me pergjegjesi te kufizuar**, me seli ne Farke, Mjull Bathore, Rruga Akacia, Tirane e regjistruar si person juridik ne QKB me date 04/01/2013 me NIPT L31304034G e perfaqesuae ligjerisht nga Ortaku i vetem, Shoqeria “NCI” shpk NIPT **L41709011G**, e perfaqesuar nga Administratori **Z. Ergys Halili**, Shoqeri e cila zoteron 100% te kapitalit te shoqerise **“ADR TRANS”**, (ne vijim blerësi);

### **Parashtruar qe:**

- Shoqëria **“PROFTRANS” Sh.p.k.** me seli Rruga Llazi Miho, zona kadastrale 3712, me numer pasurie 300/56, Vaqarr, Tirane e regjistruar si person juridik ne QKB me date 25/01/2018 me NIPT L81325027S, ka ortak Z. Ilir Vardhami, qe zotëron 2.40 % te kapitalit te shoqerise **“PROFTRANS” sh.p.k.**, me vendim te Asamblesë se Ortakeve te Shoqerise **“PROFTRANS” sh.p.k.** me date 04/12/2021, është vendosur shitja e kuotave ne masen 2.40 % te kapitalit te shoqerise qe ai perfaqeson tek blerësi **Shoqeria “ADR TRANS”**, me vendim te Asamblesë se Ortakeve te Shoqerise **“ADR TRANS” sh.p.k.** me date 05/12/2021, është vendosur blerja e kuotave ne masen 2.40 % te kapitalit te shoqerise nga ortaku i saj z. Ilir Vardhami.

Sa me sipër u parashtrua është pjese integruese e kësaj kontrate.

Palët si me sipër me vullnetin e tyre te lire vendosin si vijon:

## NENI 1 OBJEKTI KONTRATËS

Ortaku i **“PROFTRANS” sh.p.k.**, **Z. Ilir Vardhami** vendos ti shesë 2.40 % te kuotave qe zotëron ne Shoqërine **“PROFTRANS” sh.p.k.** Bleresit si ne vijim:



**Shoqeria “ADR TRANS” sh.p.k.**, e perfaqesuar nga Ortaku i vetem **Z. Ergys Halili**, i shitet 2.40 % te kuotave te kapitalit te shoqërisë dhe me numer kuote 1, i cili pranon ti blejë;

## NENI 2 ÇMIMI DHE PAGESA

2.1 Palët deklarojnë qe çmimi është paguar me mandat te rregullt bankar me vlere totale **2,400.00 ALL (dy mijë e katerqind)** dhe nuk kane me asnjë pretendim ndaj njeri tjetrit.

## NENI 3 PRONËSIA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

3.1 Pala shitëse i garanton palës blerëse se kuotat janë te lira nga çdo detyrim ligjor dhe financiar ndaj te treteve dhe për çdo pretendim qe mund te ngrene te tretet ajo është e gatshme dhe e detyruar te paraqitet me kërkesën e palës blerëse para gjithë organeve gjyqësore dhe administrative për te mbrojtur te drejtën e tij si pronar i ligjshëm i këtyre kuotave.

3.2 Pronësia e kuotave i transferohet pales blerëse ne momentin e nënshkrimit te kësaj kontrate shitblerje. Nga ky moment blerësit i transferohet pronësia e kuotave dhe si pasoje shoqëria “**PROFTRANS**” sh.p.k. do te ketë si ortake personat si vijojnë me keto ndarje:

- **Shoqeria “ADR TRANS” sh.p.k.** do te zoteroje **100 %** te kapitalit te shoqërisë i vlerësuar ne 1 kuote.

Kjo kontrate u hartua ne 2 kopje te njejta ne baze te vendimimeve te Ortakeve te shoqerive/ortakeve respektive, pjese e kesaj marreveshje, akteve te themelimit te shoqërive dhe ne baze te ligjit n. 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” dhe konform kontrates se koncesionit se dates 11.09.2009.

## PALET KONTRAKTUESE

**PALA SHITESE**  
**Z. ILIR VARDHAMI**

**PALA BLERESE**  
**Shoqria “ADR TRANS” shpk**  
**Ortaku i vetem NCI Shpk**

